



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201900570/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda :** *Rekomandohet përmirësimi i mëtejshëm i kushteve dhe i trajtimit të azilkërkuesve në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë*

**Drejtuar:** **Z. Plarent NDRECA**  
**Sekretar i Përgjithshëm Ministria e Brendshme**

**TIRANË**

**Për dijeni:** **Znj. Anila AGALLIU**  
**Drejtoreshë e Drejtorisë së Azilit**

**TIRANË**

**Të nderuar,**

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>1</sup>, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve. Inspektimi u krye në datën 16.04.2019, sipas një Plani-Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin Nertila Qafzezi, Alfred Koçobashi dhe Genci Tërpo, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi i kësaj vizite ishte verifikimi i kushteve të jetesës së azilkërkuesve në Republikën e Shqipërisë, si dhe verifikimi i respektimit të të drejtave ligjore të shtetasve që trajtohen në këtë qendër, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme. Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

<sup>1</sup> Neni 74/1 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

## Shënime paraprake

Qendra e Azilkërkuesve, është një institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme, që funksionon në bazë të ligjit nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe në bazë të Vendimit nr.332, datë 04.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit”, me qëllim strehimin e të huajve që kërkojnë azil në Republikën e Shqipërisë.

Qendra Kombëtare Pritëse është e vetmja në territorin e Republikës së Shqipërisë ku akomodohen dhe trajtohen shtetas të huaj që kërkojnë mbrojtje në Shqipëri. Azilkërkuesit janë persona të cilët janë jashtë vendit të tyre të origjinës për arsye të frikës së persekutimit, konfliktit, dhunës së përgjithshme ose rrethanave të tjera që kanë shqetësuar seriozisht rendin publik dhe si rezultat, kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Përkufizimi i refugjatëve mund të gjendet në Konventën Europiane të vitit 1951 për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të interpretuar nga Gjykata Europiane apo traktet/konventat ndërkombëtare.

Në këtë qendër strehohen azilkërkuesit pas paraqitjes së kërkesës për azil, si dhe personat të cilëve iu është refuzuar aplikimi për azil, derisa të mbarojnë procedurat e ankimit apo afatet për ushtrimin e tyre.

Përbërja e organikës e qendrës përbëhet nga 15 punonjës gjithësej, përkatësisht:

- Sektori i mbështetjes së azilantëve 3 përkatësisht 2 punonjës social dhe 1 psikolog.
- Sektori i financës dhe i shërbimeve mbështetëse 11 punonjës.

Pranimi i azilkërkuesve dhe personave të tjerë që gëzojnë mbrojtje në bazë të legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar, bëhet me akt-pranimi (akt dorëzimi) të nënshkruar nga personi i autorizuar i drejtorisë vendore për kufirin dhe migracionin ose policisë së shtetit dhe një prej specialistëve të qendrës. Një kopje e akt-pranimit (akt dorëzimit) rruhet në zyrën e protokoll-arkivës. Pas pranimit të azilkërkuesit, sektori i mbështetjes së azilantëve në bashkëpunim me sektorin e financës dhe mbështetjes me shërbime, harton plan-masash për akomodimin dhe përgatitjen e ambienteve, ku do të strehohen azilkërkuesit. Kjo qëndër ofron strehimin e azilkërkuesve, kujdesin për shërbimin shëndetsor, sigurinë e tyre, ushqimin, veshmbathjen dhe plotësimin e të gjithë nevojave jetike të tyre.

Në përputhje me procedurën grupi i monitorimit u takua me drejtuesen e këtij institucioni Znj. Anila Agalliu, të cilës iu shpjegua metodologjia dhe qëllimi i inspektimit. Nga ana e drejtuesit të institucionit u ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me rregulloren dhe pa vështirësi në të. Gjatë takimit, grupi i punës kërkoi fillimisht informacion në lidhje me mënyrën e trajtimit të personave në qendër, respektimin e të drejtave të azilkërkuesve.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, nga kontakti me stafin e institucionit, kqyrja e dokumentacionit, e objekteve dhe mjediseve, rezultoi se rekomandimet e dërguara pas inspektimit të bërë në vitin 2017, ndonëse janë pranuar në parim, janë zbatuar vetëm pjesërisht.

Konkretisht:

### **Ishin plotësuar rekomandimet :**

Mbi përfundimin e rikonstruksionit të mjediseve të qëndrës sipas parashikimeve në projekt.

### **Ishte plotësuar rekomandimi :**

Hartimin e projektiligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.121/2014" Për Azilin në Republikën e Shqipërisë. Urdhër Nr.460 dt 30.08.2018, me qëllim garantimin e plotë të drejtave që ju njeh ky ligj azilkërkuesve.

### **Ishte plotësuar rekomandimi :**

Miratimi i rregullores së re të qëndrës në zbatim të ligjit nr.121/2014 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".

### **Ndërkohë që një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit, më parë nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar, si vijon:**

- a. Vazhdonte të ishte një problematikë, normativa për trajtimin e personave që akomodohen në këtë qendër, duke mos pasur asnjë normë trajtimi për këtë institucion (ushqim, veshmbathje, detergjentë, gas). Në mënyrë të vazhdueshme, janë bërë përpjekje nga ana e institucionit për zgjidhjen e këtij problemi. Më e fundit është shkresa me nr.13 prot datë 10.01.2017 për "Përcaktimin e normativave". Kuota ditore e përdorur prej vitesh për një person është 330 (treqind e tridhjet) lekë për person, një shumë kjo tepër e ulët duke ju referuar rritjes së çmimeve të ushqimeve në vite. Nisur nga kjo mënyra e të ushqyerit, veshmbathjet, detergjentët për trajtimin e azilkërkuesve është një proces kompleks dhe dinamik sepse në këtë qendër akomodohen kategori të ndryshme personash, (persona që kanë probleme të ndryshme me shëndetin, gra shtatzëna, fëmijë të porsalindur etj.) kjo bën që puna rreth procesit të ushqyerjes të ketë një kosto më të lartë.
- b. Nuk ishte plotësuar rekomandimi për krijimin e një këndi lojrash për fëmijet, si dhe një fushe sportive të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve sportive të kësaj qendre. Theksojmë se fusha aktuale e parashikuar për zhvillimin e aktiviteteve sportive është e papërshtatshme, sepse ajo është e shtruar me beton dhe mund të jetë burim aksidenti.
- c. Vazhdonte të ishte paplotësuar rekomandimi për plotësimin e organikës së brendshme të institucionit. Rekomandimi i fundit ku institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon: (Marrjen e masave për shtimin e organikës të kësaj qendre minimalisht me një edukator, një stomatolog dhe një kujdestar). Përpjekje janë bërë edhe nga institucioni, nëpërmjet shkresave përcjellëse, ku herë pas here i është drejtuar Ministrisë së Brëndshme, kërkesë për mbështetje me punonjës me kontratë me specialitetet e përcaktuara si : Mjek, Infermier, Kujdestar, Punonjës Social, Kujdestar, Përkthyes. Shkresa Nr.Prot 166 Dt.02.03.2018.

Kjo problematikë është e vazhdueshme duke marrë parasysh faktin se prej vitit 2017 e në vazhdim numri i azilkërkuesve ka pësuar rritje për shkak të situatave në rajon dhe më gjërë.

**Përgjatë inspektimit konstatohet se :**

- a. Mungesa e një përkthyesi të gjuhës arabe e cila sillte një problematikë në komunikim ndërmjet azilkerkuësve dhe punonjësve të institucionit.
- b. Mungesa e mjekut dhe infermierit, për tju ofruar ndihmë mjekësore në momentin e mbërritjes e në vazhdim duke përmendur faktin që këta njerëz në të shumtën e rasteve paraqiten në gjëndje të rënduar shëndetësore. Momentalisht për një periudhë 6-mujore ishte ofruar një infermier nga bashkëpunimi me shoqatën RMSA (“Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë”), por shërbimi duhet të jepet nga shteti në mënyrë të vazhdueshme.
- c. Menaxhimi i azilkërkuesve, sidomos në orët e mesditës dhe gjatë orëve të natës ishte kthyer në një problem për qendrën. Momentalisht shërbimi i natës me një numër prej dy (2) kujdestarë, mbulohen nga RMSA dhe UNHCR, për një periudhë 6 mujore. Mbulimi i këtyre pozicioneve dhe shtimi i tyre në organike, duke u nisur nga situata e deritanishme është i domosdoshëm, duke qënë se vijnë nga vënde të ndryshme, kanë konflikte midis tyre deri në agravim të situatave, gjë për të cilën në disa raste institucioni ka kërkuar mbështetjen e komisarariatit nr.5.
- d. Mungesa e një mirëmbajtësi ndihej ndjeshëm, numri i lartë i azilkërkuesve dhe gama e gjerë e shërbimeve në qendër, bëheshin shkak për dëmtime të infrastrukturës së brendshme të godinës.
- e. Vazhdonte të ishte problem mungesa e punonjësve social. Aktualisht në qendër kishte vetëm 1(një) punonjës social dhe 1 psikolog, kjo situatë e bënte të pamundur ofrimin e shërbimit për një numër të shtuar azilkërkuesish.  
Theksojmë se punonjësi social është pozicioni kyç në ofrimin e shërbimit të drejtpërdrejtë me azilantët. Punonjësi social është ai që përballet me problemet e përditshme të azilkërkuesve, në plotësimin e nevojave të tyre të përditshme, në ofrimin e shërbimeve, plotësimin e kërkesave, asistencën sociale, shoqërimin e tyre në ambientet spitalore etj.

Kapaciteti zyrtar i kësaj qendre është 180 persona, sipas pajisjes me shtretër. Në mjediset e institucionit në kohën e inspektimit ndodheshin 164 persona nga këta: meshkuj të rritur 89 , meshkuj minorene 31, femra të rritura 25, femra minorene 19.

Ndërkohë pritej mbërritja e 29 azilkërkuesve nga Drejtoria e Kufirit Korçë. Në rastet kur numri i azilkërkuesve e tejkalonte kapacitetin, institucioni i akomodonte në ambiente të tjera si salla e pritjes, e lojërave dhe argëtimit.

Grupi i punës pasi mori informacionin e nevojshëm, inspektoi ambientet e kësaj qendre. Nga kqyrja në vend gjatë inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambienteve ishte përmirësuar ndjeshëm me përfundimin e godinës së re, 4-katëshe për akomodimin e azilkërkuesve. Megjithëse gjatë monitorimit konstatuam dëmtime të shumta në infrastukturën e brendshme kjo për shkak të fluksit në rritje të azilkërkuesve prej vitit 2017. Për vitin 2018 në qender janë paraqitur 4371 total prej të cilëve 159 femra nën moshën 18 vjeç dhe 310 meshkuj nën moshën 310. Të rritur femra janë paraqitur 246 dhe meshkuj 3656.

### **1. Trajtimi**

Gjatë vizitës monitoruese, grupi inspektues pati si objekt të punës së tij mbledhjen informacionit lidhur me trajtimin e azilkërkuesve të strehuar në këtë qendër të hapur, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, të dhunës fizike, apo të ushtrimit të forcës tej kufijve të parashikuar nga aktet normative në fuqi ndaj kësaj kategorie. Grupi inspektues mori kontakt me pjesën më të madhe të azilkërkuesve që gjendeshin në qendër dhe bisedoi me ta në mënyrë konfidenciale. Nga bisedat e kryera nuk rezultoi që ndaj tyre të ishte ushtruar dhunë fizike apo psikologjike nga personeli i qendrës. Azilkërkuesit të cilët dyshohet se mund të kenë qenë viktima të torturës deri në momentin e mbërritjes në institucion apo akteve të tjera të rënda të dhunës, qoftë kjo seksuale, fizike apo psikologjike, i krijohen mundësitë për këshillim dhe/ose trajtim të veçantë mjekësor dhe psikologjik.

Për çdo rast vlerësohet gjendja e tyre nga punonjësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilantëve, e më pas shihet mundësia që rasti të trajtohet brenda ambienteve të QKPA-(Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve) apo të referohet në instanca më të specializuara.

Trajtimi me ushqim i azilkërkuesve bëhej mbështetur në një kuotë të ulët, rreth 330 (treqind e tridhjetë) lekë/në ditë, e cila paraqiste vështirësi për përmbushjen e nevojave.

### **2. Masat mbrojtëse**

Personat e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve që u intervistuan nga grupi i inspektimit, pohuan se mund të dilnin nga institucioni dhe se mund të zhvillonin aktivitetet e tyre personale pa probleme, duke gjetur mbështetje nga stafi i qendrës.

Një problematikë e pazgjidhur ndër vite, e cila u evidentua edhe përgjatë këtij inspektimi ishte qëndrimi afatgjatë i personave në këtë qendër, përkatësisht 18 persona. Koha e qëndrimit varionte nga dy javë deri në disa vite, duke e bërë edhe më të vështirë akomodimin në periudhën kur ka fluks emigrantesh, si dhe integrimin e tyre në shoqëri. Kjo e pasqyruar edhe në numrin e personave të rikthyer nga drejtoria e kufirit të cilët nga periudha Janar-Mars 2019 janë 271 (dyqind e shtatëdhjetë e një) azilantë.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në godinën e re të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera në mjediset e përbashkëta, jo në ato të banimit. Siguria e ambienteve të qendrës bëhej ndërmjet një kompanie të shërbimit privat të sigurisë fizike. Sistemi i kamerave monitorohej nga punonjësi i sigurisë.

Për shtetasit e huaj të pranuar, QKPA siguron shërbimet e mëposhtme sipas një plani të detajuar 1-mujor:

- Akomodim dhe strehim të përshtatshëm në varësi të gjendjes familjare të të huajit si dhe kushteve të strehimit që disponon qendra;
- Ushqim të gatuar dhe ambiente të përshtatshme e bashkëkohore në mence të përbashkët;
- Materiale të ndryshme higjeno-sanitare për higjenë personale;
- Trajtim psikologjik nga specialistët e fushës;
- Trajtim shëndetësor në qendra shëndetësore shtetërore ose private (në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtare);
- Konsulencë juridike mbi legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar për personat që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare;
- Ofrohet biblioteka, salla e lojrave, shërbim interneti;
- Për fëmijët ambient i veçantë i pajisur me biblioteke dhe lojra të ndryshme sipas grupmoshave.

Qendra kishte një rregullore të re, të miratuar në mbështetje të ligjit nr.121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

### **3. Kushtet materiale**

Struktura e kësaj qendre përbëhej nga: një godinë 4 (katër) katëshe dhe 5 (pesë godina njëkatëshe) e ndërtuar nga donatori UNHCR me fonde të BE-së, e cila kryen disa funksione: Në katin e parë është kuzhina bashkë me ambjentin e mensës dhe dy tualete, lavanderia, infirmieria, dhoma e personave me aftësi të kufizuara, salla e kamerave të sigurisë. Në katin e dytë janë vendosur salla e internetit, biblioteka, dhoma e fëmijëve për orët argëtuese dhe edukative, gjithashtu, po në këtë kat ndodhet edhe dhoma e akomodimit për azilkërkuesit. Kati i tretë dhe i katërt është i gjithi për akomodime për azilkërkuesit të pajisura me tualete për të gjitha ambientet, me sistem ngrohjeje dhe ftohjeje, ujë të ngrohtë 24 orë. Godina njëkatëshe janë 5(pesë) 3(tre) godina janë ambiente akomoduese dhe me tualetet përkatëse, me sistem ngrohje dhe ftohje, me ujë të ngrohtë njëzet e katër orë. 1 (një sallë) priteje dhe intervistimi në momentin e mbërritjes të azilkërkuesve. 2 (dy) godina të tjera, janë zyra për administratën dhe ambiente ndihmëse për administrimin e qendres (magazina).

Qendra menaxhohej me fondet e buxhetit të shtetit, ndërsa pajisjet dhe gjithçka tjetër mbi arredimin, ishin mbuluar nga UNCHR.

Lavanderia ishte në kushte shumë të mira, me 5 lavatriçe të reja, si dhe pranë saj shërbente sanitarja e qendrës. Kuzhina ishte e pastër, kishte mjaftueshëm tavolina dhe karrige për azilkërkuesit. Punonjëset e saj ishin të pajisura me librezë dhe kushtet higjienike ishin të mira. Menuja e përditshme ishte e afishuar. Për të rriturit ofroheshin 3 vakte në ditë dhe për fëmijët 4. Kampionët ushqimorë ruheshin në një ambient frigoriferik. Sikurse u konstatua në vend nga grupi i inspektimit, edhe nga intervistat e bëra me azilantët e akomoduar në qendër, ushqimi ishte i një cilësie të mirë. Në momentin e inspektimit nuk kishte kërkesa të posaçme lidhur me dietën ushqimore. Në katet e sipërme të godinës së re, miediset e banimit ishin të strukturuar në dhoma të mëdha, të pajisura me tualete dhe me dush brenda. Në ambientet e qendrës kishte gjithashtu edhe Wi-Fi.

Dhomat e banuara kishin dritë natyrale dhe artificiale dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme të reja. Sistemi i ngrohjes së ujit, kryhej përmes paneleve diellore.

Në përgjithësi, në të gjitha intervistat e kryera, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishte mungesa në furnizimin e azilkërkuesve me shtroje, mjete të tjera të higjienës personale dhe asaj të përbashkët.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte pa kufizim oraresh dhe nuk u konstatuan probleme as me energjinë elektrike. Për këtë të fundit kishte edhe një gjenerator në raste ndërprerjeje të energjisë.

Grupi i monitorimit konstatoi se në oborrin e qendrës kishte një mjedis të jashtëm të rrethuar, i cili përdorej për basketboll dhe kalçeto, por ishte i shtruar me beton dhe ishte i papërshtatshëm për aktivitete sportive, mungonte një kënd lojërash i jashtëm për fëmijët.

#### **4. Aktivitetet**

Nisur nga fakti se qendra ishte e hapur, personat e strehuar në të ishin të lirë të punonin, të dilnin nga qendra, apo edhe të kryenin aktivitete të tjera personale. Pavarësisht kësaj, stafi i kësaj qendre, i përbërë prej 15 vetash, organizonte herë pas here aktivitete të përbashkëta, të tilla si ditëlindje, gjatë verës vajtje në pishina, ndeshje futbollit dhe basketbollit, etj. Ambiente kulturi nuk kishte.

Kjo qendër kishte nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit lidhur me arsimimin 9-vjeçar të fëmijëve të strehuar në këtë qendër. Nga intervistat me vetë fëmijët, grupi i inspektimit u bë me dije se aktualisht ata ndiqnin mësimin në shkollat publike shtetërore rregullisht dhe këto shkolla ndodhen afër qendrës.

Biblioteka funksiononte dhe kishte një numër të konsiderueshëm titujsh në gjuhët angleze dhe arabe. Tërheqja dhe kthimi i librave bëhej duke shënuar të dhënat përkatëse në një kartelë personale. Gjithashtu, kishte edhe një ambient të përbashkët për ndjekjen e programeve televizive.

Kurset profesionale ofroheshin në bashkëpunim me RMSA-në “Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë”, përmendim ato për mekanikë, gjuhë të huaja, parukeri, kompjuter, lejedrejtimi etj.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit, grupi i inspektimit vuri re se stafi i qendrës mbante regjistrin elektronik themeltar për të gjithë personat e strehuar në qendër, si dhe regjistrin themeltar të sekretuar. Secili prej tyre kishte një dosje specifike me të gjithë dokumentacionin e duhur dhe zhvilloheshin takime të veçanta nga stafi psiko-social me ta. Për regjistrimin e azilkërkuesve përdoren këto mënyra:

- a) Data base e azilit
- b) Regjistri elektronik (exel)
- c) Regjistri i sekretuar.

Sektori i mbështetjes së Azilkërkuesve bën regjistrimin e azilkërkuesve nga regjistri në formë elektronike dhe regjistri i sekretuar.

Sektori i mbështetjes së azilantëve bën përditësimin e të dhënave.

Regjistri i azilkërkuesve mban të dhënat demografike të azilkërkuesve të akomoduar.

## 5. Shërbimi shëndetësor

Organika e qendrës kishte mungesa në mjek me kohë të plotë, infermier dhe stomatolog, këto shërbime vijojnë të mos ofrohen nga qendra, por në bashkëpunim me RMSA (Organizata Shërbimet Shqipëtare për Refugjatët ) dhe UNHCR është mbuluar pozicioni i një infermieri për një periudhë 6-mujore. Me rikonstruksionin e mjediseve të qendrës, ishte parashikuar një dhomë e veçantë për mjekun me të gjitha pajisjet e duhura. Nuk kishte mungesa në furnizimin me medikamente.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë, por në raste emergjente përdoreshin makinat e qendrës për transportimin e azilkërkuesve pranë qendrave spitalore.

Gjithashtu ishin të hapura librezat shëndetësore për të gjithë azilkërkuesit e akomoduar në qendër, dhe skema e rimbursimit të ilaçeve ishte në funksion të plotë. Medikamentet mjekësore të rimbursueshme përfitoheshin me të njëjtën praktikë si shtetasit e tjerë të Republikës së Shqipërisë, në rastin konkret nga fondet e qendrës. Ndërsa medikamentet mjekësore të parimbursueshme bliheshin sipas procedurave të prokurimit publik.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit Nr. 8454 datë. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 9888 datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 datë 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”* ku parashikohet midis të tjerash se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtërues”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për rritjen e kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të ushqimeve në vite.
2. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin në organikë të kësaj qendre minimalisht me :
  - a. Mjek të përgjithshëm
  - b. Infermier
  - c. Punonjës social
  - d. Kujdestar Nate
  - e. Përkthyes
  - f. Mirmbajtës
  - g. Sanitare



3. Marrjen e masave për krijimin e nje këndi lojrash për fëmijët dhe një fushë sportive të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve sportive.
4. Marrjen e masave për integrimin në shoqëri të personave të strehuar në qendër, gjë që duhet të reflektohet edhe në një qëndrim më afat-shkurtër të këtyre personave në mjediset e kësaj qendre.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERE**

**ERMONELA XHAFA**